



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 123

20 shtator

2012

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 564, datë 22.8.2012	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Ungrej të qarkut të Lezhës 6903
Vendim i KM nr. 565, datë 22.8.2012	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Fierzë të qarkut të Kukësit.... 6904
Vendim i KM nr. 566, datë 22.8.2012	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Hajmel të qarkut të Shkodrës 6905
Vendim i KM nr. 571, datë 29.8.2012	Për lejimin e përdorimit të pjesshëm të të ardhurave të realizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë gjatë shërbimeve metrologjike, për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe njohjen ndërkombëtare të etaloneve kombëtare të matjeve... 6906
Vendim i KM nr. 572, datë 29.8.2012	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Qarr” e “Kaltanj” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë..... 6906
Vendim i KM nr. 573, datë 29.8.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për ndërtimin e objektit “Mauzoleu i Familjes Mbretërore”..... 6907
Urdhër i MD nr. 5504/2, datë 14.9.2012	Për një ndryshim në urdhrin nr. 5591, datë 5.8.2011 “Për krijimin e komisionit disiplinor të përmbaruesve gjyqësorë privatë”..... 6908

Vendim i ERE nr. 114, datë 22.8.2012	Mbi kërkesën e “Cez Shpërndarje” sh.a. për moszhvillimin e ankandit të kapaciteteve në drejtimin import, muajt: shtator, tetor, nëntor, dhjetor të vitit 2012.....	6908
Vendim i ERE nr. 115, datë 22.8.2012	Për fillim procedure për rinovimin e licencës “Për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike”, me nr. 68 seria P08FPP, të miratuar me vendimet e bordit të komisionerëve nr. 9, datë 25.1.2008 dhe nr. 58, datë 3.6.2008.....	6910
Vendim i ERE nr. 116, datë 22.8.2012	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Energji Xhaci” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Mollaj”.....	6911
Vendim i ERE nr. 117, datë 22.8.2012	Për licencimin e shoqërisë “E.T.H.H.” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et “Kozel”, “Helmes 1” dhe “Helmes 2”.....	6912
Vendim i ERE nr. 118, datë 22.8.2012	Për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.....	6913
Vendim i ERE nr. 119, datë 22.8.2012	Për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.....	6914

VENDIM

Nr. 564, datë 22.8.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS UNGREJ TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Ungrej të qarkut të Lezhës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Ungrej të qarkut të Lezhës, miratuar me vendimin nr. 1261, datë 17.9.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Ungrej të qarkut të Lezhës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Ungrej për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Ungrej Lezhë

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
379	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
381-388	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
389-391	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
392-397	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
398	Varreza publike	Në pronësi
399-402	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
403-406	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
410-427	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
428, 431-434, 436 (vetëm kanale të treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
437-517	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi



VENDIM
Nr. 565, datë 22.8.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS FIERZË TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Fierzë që qarkut të Kukësit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 97 (nëntëdhjetë e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi përfundon me numrin rendor 636 (gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Fierzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Fierzë

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
10-12, 627-630	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
9	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
16-40	Varreza publike	Në pronësi
83, 84, 86, 88, 89-90, 631-633 (vetëm trojet e lira)	Infrastrukturë, troje të lira dhe hapësira publike të pazëna, ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
41-43, 44-49, 50-71, 636	Prona që përdoren në fushën e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve	Në pronësi
78-82, 85, 87, 89-90, (vetëm sheshet dhe sipërfaqet e gjelbëruara), 91-98,635	Infrastrukturë, sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike	Në pronësi
507, 508, 510-512, 514, 515	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim

509, 513	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
545-549	Prona që përdoren në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi
101-110	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi

VENDIM

Nr. 566, datë 22.8.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS HAJMEL TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Hajmel të qarkut të Shkodrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 451 (katërqind e pesëdhjetë e një).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna e Hajmel për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Hajmel

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative	Në pronësi
2-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
9-10, 448-451	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
11-191, 192, 194-200, 202-203, 205-207	Infrastrukturë (rrugë vendore, sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
193, 201, 204	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim



221-225	Varreza publike	Në pronësi
226-237	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
238, 246, 249, 253, 259, 261, 265, 279, 285	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi

VENDIM

Nr. 571, datë 29.8.2012

PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË PJESSHËM TË TË ARDHURAVE TË REALIZUARA NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË GJATË SHËRBIMEVE METROLOGJIKE, PËR ZHVILLIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE NJOHJEN NDËRKOMBËTARE TË ETALONEVE KOMBËTARE TË MATJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë të përdorë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, nga të ardhurat që siguron nga shërbimet metrologjike, për çdo vit buxhetor.
 2. Këto të ardhura të përdoren për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe njohjen ndërkombëtare të etaloneve shqiptare të matjeve, sipas përcaktimeve në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
 3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 572, datë 29.8.2012

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “QARR” E “KALTANJ” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve “Qarr” e “Kaltanj” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën konkurruese përzgjedhëse, për dhënien me koncesion të këtyre hidrocentraleve, që i jepet shoqërisë “Favina 1” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Qarr” e “Kaltanj”, të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 573, datë 29.8.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT
“MAUZOLEU I FAMILJES MBRETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikës e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitin 2012”, me propozimin e Ministrisë të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në artikullin 231 “Shpenzime kapitale të trupëzuara”, t’i shtohet fondi i përgjithshëm prej 20 825 999 (njëzet milionë e tetëqind e njëzet e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekësh, për ndërtimin e objektit “Mauzoleu i Familjes Mbretërore”, Tiranë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ministria e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



URDHËR
Nr. 5504/2, datë 14.9.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHURIN NR. 5591, DATË 5.8.2011 “PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT DISIPLINOR TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 51 të ligjit nr. 10 031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 5591, datë 5.8.2011 “Për krijimin e komisionit disiplinor të përbaruesve gjyqësorë privatë”, në pikën 1, bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Z. Shaqir Hasani, avokat në cilësinë e anëtarit, zëvendësohet me z. Arben Vani, avokat në cilësinë e anëtarit.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij urdhri Komisionit Disiplinor të Përbaruesve Gjyqësorë Privatë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

VENDIM
Nr. 114, datë 22.8.2012

MBI KËRKESËN E “CEZ SHPËRNDARJE” SHA PËR MOSZHVILLIMIN E ANKANDIT TË KAPACITETEVE NË DREJTIMIN IMPORT, MUAJT: SHTATOR, TETOR, NËNTOR, DHJETOR TË VITIT 2012

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “ç” paragrafi “ii” dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 7 germa “b” të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe kapitullit X të “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, të miratuara nga ERE me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.8.2012, pasi shqyrtoi kërkesat e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. me nr. 4387/2 prot., datë 27.7.2012 dhe nr. 4805 prot., datë 30.7.2012, si dhe relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstaton se:

- Nivelet e rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin, si dhe basenet e tjera të hec-eve që operojnë në vendin tonë janë të ulëta. Niveli i ujit në liqenin e Fierzës është në nivelin 281.31 metra dhe në fund të muajit gusht, pritët të shkojë në 265 metra, nivele këto që bëjnë të pamundur garantimin e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve në periudhën në vijim.

- “CEZ Shpërndarje” është subjekti përgjegjës për të mbuluar humbjet jo vetëm për muajin aktual dhe në vijim por edhe për periudhën pararendëse, si pasojë e mbulimit të diferencës së krijuar me KESH sh.a., dhe sa më sipër reflekton në një rritje të kërkesës për energji dhe si të tillë të sasisë së energjisë elektrike për t’u importuar nga CEZ.

- Pretendimi i paraqitur nga ana e “CEZ Shpërndarje” për tendencë të bllokimit të kapaciteteve nga tregtarët, të cilët nuk rezultojnë të kenë kontrata efektive dhe praktikisht nuk përdoren ose spekulohet përmes çmimeve shumë të larta në shitjen e energjisë elektrike, nuk është vërtetuar nga asnjë dokument provues të depozituar nga “CEZ Shpërndarje”.

- Nga të dhënat e raportuara nga OST sh.a. dhe KESH sh.a., sipas shkresës nr. 3714 prot., datë 14.8.2012, “CEZ Shpërndarje” sh.a., megjithëse bazuar në vendimin nr. 111, datë 31.7.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, i janë alokuar falas për muajin gusht 2012, kapacitetet e interkonjeksionit të drejtimit të importit me linjat e veriut për sasinë 80 MW, sërish nuk ka përmbushur detyrimin për importin e plotë të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes.

- Gjithashtu, po sipas këtij komunikimi, është ngritur shqetësimi i mosimportimit nga CEZ Shpërndarje, jo vetëm në kapacitetin e kërkuar, por importi kryhet në kapacitete jo të njëtrajtshme dhe jo në bandë.

- Kërkesa e OST sh.a. për alokimin e kapaciteteve për “CEZ Shpërndarje” sh.a. kundrejt pagesës së njëjtë me ato të ankandeve vjetore, nuk u pranua nga “CEZ Shpërndarje”, por nga ana tjetër në gjykimin tonë kjo kërkesë e OST-së do të vendoste të gjithë pjesëmarrësit e tregut minimalisht në kushte të barabarta për efekt të pagesave.

- Siç është bërë prezent edhe më parë, pas disa nga komunikimeve të ERE-s me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, ky i fundit është shprehur dakord, që për një periudhë transitorë, por jo më vonë se fundi i vitit 2012, ERE-ja të mundë të lejojë përdorimin nga “CEZ Shpërndarje” të kapaciteteve të limituara jashtë procedurave të ankandit të alokimit të kapaciteteve, për aq sa nevojitet për të siguruar furnizimin publik të konsumatorëve.

- Për gjithë sa më sipër, me qëllim moscenimin e furnizimit pa ndërprerje me energji elektrike të konsumatorëve tariforë dhe të kualifikuar të energjisë elektrike, bazuar në nenin 8 pika 2 germa “ç” paragrafi “ii” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, sipas të cilit ERE-ja është autoriteti përgjegjës për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, duke garantuar ndër të tjera, që kushtet e shërbimit, si: cilësia, efica, qëndrueshmëria dhe siguria e furnizimit me energji elektrike janë të përshtatshme, sipas rrethanave, si dhe meqenëse ERE-ja është gjithashtu autoriteti përgjegjës për miratimin e rregullave të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Alokimin e kapaciteteve disponibël të interkonjeksionit për muajin shtator 2012, si më poshtë:

a) Shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për sasinë 155 MW, për mbulimin e humbjeve të ndara sipas kufirit dhe periudhave të përcaktuara nga OST sh.a. (shkresa e OST sh.a. nr. 3851/1, datë 8.8.2012);

b) Klientëve të kualifikuar për sasinë 45 MW, të ndarë proporcionalisht, sipas kufirit dhe periudhave të përcaktuara nga OST sh.a.

2. Alokimi i kapaciteteve sipas pikës 1 të këtij vendimi, të bëhet kundrejt pagesës për kapacitet sipas skemës:

Kufiri	Çmimi (€/MWh)
Mali i Zi	3.18
Kosovë	3.13
Greqi	0.11

3. “CEZ Shpërndarje” sh.a. dhe furnizuesit e kualifikuar të bëjnë nominimet dhe pagesat për kapacitetet e interkonjeksionit, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, për muajin shtator 2012, deri në datën 27.8.2012.



4. OST sh.a. të zhvillojë ankandin për muajin shtator 2012, brenda datës 29.8.2012, në rast të moszbatimit të pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi.

5. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OST sh.a. dhe “CEZ Shpërndarje” sh.a., për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 115, datë 22.8.2012

PËR FILLIM PROCEDURE PËR RINOVIMIN E LICENCËS “PËR AKTIVITETIN E FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, ME NR. 68 SERIA P08FPP, TË MIRATUAR ME VENDIMET E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 9, DATË 25.1.2008 DHE NR. 58, DATË 3.6.2008

Në mbështetje të nenit 9 dhe 13 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 pikës 3 dhe nenit 16 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, pikave 1.6 dhe 1.8 të licencës “Për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike”, dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. “Për rinovimin e licencës në aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE-ja në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”,

- Neni 9 pika 1:

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9 pika 2:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar tërësisht.

- Neni 9 pika 3:

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar tërësisht.

- Neni 9 pika 4:

Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për klientët tarifore është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojnë procedurat për rinovimin e licencës së shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. me nr. 68 seria P08FPP “Për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimet e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 25.1.2008 dhe nr. 58, datë 3.6.2008.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 116, datë 22.8.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGJI
XHACI” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HEC “MOLLAJ”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a” dhe nenit 10 pikat 1, 3 dhe 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energji Xhaci” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energji Xhaci” sh.p.k., plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE-ja në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9 pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me miratimin e pikës së lidhjes me sistemin e shpërndarjes dhe marrja e lejes mjedisore janë në proces miratimi (neni 9 pika 4.1.5, leje nga institucione të tjera).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojnë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Energji Xhaci” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Mollaj”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr. 117, datë 22.8.2012

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “E.T.H.H.” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “KOZEL”, “HELMES 1” DHE “HELMES 2”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pikës 1 germës “a”, nenit 5 pika 1 germa “a” dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “E.T.H.H.” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “E.T.H.H.” sh.p.k., plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE-ja në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9 pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Kërkesa që ka të bëjë me lejet nga institucionet e tjera (pika e lidhjes nga rrjeti i shpërndarjes; neni 9 pika 4.1.5) mungon. Por, duke qenë se aksesin në rrjetin e gjeneruesve të vegjël është i garantuar sipas ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pika 29 e nenit 3 dhe neni 42, konsiderojmë se një kërkesë e tij mund të plotësohet në një kohë tjetër pa cenuar procesin e licencimit të këtij subjekti.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “E.T.H.H.” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et: “Kozel” me fuqi 0,5 MW; “Helmes 1” me fuqi 0,8 MW; dhe “Helmes 2” me fuqi 0,5 MW, për një afat 30-vjeçar”.

2. Shoqëria E.T.H.H. sh.p.k. të paraqesë në ERE lejen e pikës së lidhjes me rrjetin e shpërndarjes brenda 30 ditëve nga miratimi i saj.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 118, datë 22.8.2012

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBPETROL” SHA NË AKTIVITETIN E
TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, nenit 14 pika 1 germa “a”, si dhe të “Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesëshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, nenit 4 pika 1 germa “a”, nenit 5, nenit 8, nenit 9 pika 1 germave “a”, “b”, “c”, “d”, pika 2 germa “a” dhe nenin 11 dhe 12 pika 1, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 11.2.2011, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albpetrol” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albpetrol” sh.a., për licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror të kësaj shoqërie plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE-ja në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”,

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, sipas licencës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. do të paguajë tarifën e aplikimit në momentin e miratimit të saj nga ERE-ja.
3. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. detyrohet të zbatojë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror” dhe kushteve të licencës bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr. 119, datë 22.8.2012

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBPETROL” SHA NË AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, nenit 14 pika 1 germë “b”, si dhe të “Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, nenit 4 pika 1 germa “b”, nenit 5, nenit 8, nenit 9 pika 1, germave “a”, “b”, “c”, “d”, pika 2 germa “a” dhe nenit 11 dhe 12 pika 1, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 11.2.2011, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albpetrol” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrotjtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albpetrol” sh.a., për licencimin në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror të kësaj shoqërie plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE-ja në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e shpërndarjes të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar.
2. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. do të paguajë tarifën e aplikimit në momentin e miratimit të saj nga ERE-ja.
3. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. detyrohet të zbatojë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror” dhe kushteve të licencës bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 20.9.2012
Doli nga shtypi më 20.9.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 20 lekë